



URDHËR

Nr. 114, Datë 04/11/2015

Mbi

konkurset e pranimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave"/"Master i Arteve të Bukura", dhe tarifën e regjistrimit për vitin akademik 2015-2016, në Universitetin e Arteve.

Mbështetur në nenet 26, 34, 75, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 6, 135 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 638, datë 22.07.2015, "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimit, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të me kohë të plotë, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave"/"Master i arteve të Bukura", për vitin akademik 2014 - 2015", Udhëzimit nr. 50, datë 03.11.2015 të MAS, nenit 39, të Statutit të Universitetit të Arteve,

URDHËROJ:

1. Konkurrentët që aplikojnë për ciklin e dytë me kohë të plotë, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave"/"Master i Arteve të Bukura", në Fakultetet e Universitetit të Arteve, për vitin akademik 2015 - 2016, të përzgjidhen sipas kriterëve dhe rregulloreve përkatëse, të miratuara nga Senati Akademik i UART, respektivisht: VSA Nr. 9 datë 15.05.2015 FAS; VSA Nr. 10 datë 15.05.2015 FAB; VSA Nr. 11 datë 15.05.2015 FM. Komisionet emërohen nga Dekani i Fakultetit;
2. Konkursi e pranimit të zhvillohen nga data **10.11.2015 deri më datë 12.11.2015;**
3. Brenda datës **04.11.2015, deri në orën 16⁰⁰,** Dekanët e Fakulteteve, të shpallin në mjediset e fakulteteve dhe në faqet Web të tyre, oraret e veprimeve të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për të siguruar një ecuri normale të procesit të regjistrimit në konkurset e pranimit;



4. Kandidatët brenda vendit, si dhe kandidatët shqiptar, që do të marrin pjesë në konkurset e pranimit për këto programe studimi, nga Republika e Kosovës, nga Republika e Maqedonisë, nga Republika e Malit të Zi dhe nga Presheva, Bujanovsi dhe Medvegja, të regjistrohen nga datë 04.11.2015 deri në datën 06.11.2015;
5. Bazuar në pikën 9, të Udhëzimit nr. 50, datë 03.11.2015 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, tarifa e regjistrimit të kandidatëve pjesëmarrës **në konkurset e pranimit** është: **3,000 lekë**;
6. Dekanët shpallin brenda **datës 16.11.2015**, rezultatet e fituesve të konkursit për ciklin e dytë të studimeve, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave"/"Master i Arteve të Bukura", dhe i dërgojnë ato në formë shkresore dhe elektronike në CD, në Rektorat, MAS, dhe në AKP;
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Zv./rektori për anën mësimore, Kancelari, Dekanët dhe Sekretarët e Fakulteteve, Drejtoria Ekonomike, Sektori Mësimore & Informimit, Sektori i IT, dhe Sektori i Informacionit të Statistikës pranë Rektoratit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Petrit MALAJ

REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE